

Z. Albion Kadriu

Mban pozicionin e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë. Është diplomuar në vitin 2010 në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ka fituar titullin “Inxhinier”, si dhe titullin “Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme”, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pas përfundimit të studimeve, z. Kadriu e nisi karrierën profesionale në drejtori të ndryshme, në varësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, fillimisht si specialist e më pas është promovuar në pozicionin e përgjegjës të sektorit. Ka eksperiencë profesionale si inxhinier zbatimi dhe si ekspert i vlerësimit të pasurive të paluajtshme në gjykata të vendit. Gjatë karrierës, z. Kadriu ka kryer trajnime të ndryshme si dhe master profesional në Politikën e Zhvillimit të Territorit, për Planifikim Hapsinor dhe Aplikime në GIS.